

EDITORIALI

1,55

Ka q është "fondi" ditor për gati një të tretën e popullsisë në Kosovë. A jeton dot njeriu me kaq pak para? Në Kosovë duket se ia del disi. Dhjetëra mijëra qytetarë të Republikës, një euro e pesëdhjetë centë duhet t'i ndajnë për bukë, ushqime, veshmbathje...Nuk po flasim këtu për t'i dërguar fëmijët në shkollë dhe për t'ua plotësuar kërkesat elementare. Tridhjetë për qind e popullatës lufton për jetën, pa ndonjë shpresë se gjendja e tyre do të përmirësohet një ditë. Fatkeqësisht, kjo kategori është e harruar. Për ta flitet në rastet e publikimit të statistikave, apo kur vjen festa e Bajramit dhe presin ndonjë ndihmë humanitare. Në fjalorin pushtetor, të varfrit nuk kanë vend. A i keni dëgjuar ndonjëherë qeveritarët të flasin për ta? A i keni parë, qoftë edhe një herë të vetme, t'ua bëjnë ndonjë vizitë dhe të solidarizohen me vuajtjen e tyre? Politikanët në Kosovë, jo rastësisht trashen nga mandati në mandat, aq sa edhe në ato veturat e tyre luksoze mezi hipin. Luftimi i varfërisë është njëri ndër objektivat e Mileniumit, por nuk është marrë seriozisht nga institucionet tona. Në Kuvend debatohet për gjithfarë temash, polemizohet se kush prej nga është dhe i kujt është, por nuk u shkon goja të flasin për skamjen që e ka pushtuar këtë vend. Të mos jetë edhe ndonjë media e pavarur, që e pasqyron realitetin, historitë tronditëse të kosovarëve do të mbuloheshin nga terri informativ. Në mbrëmje, në ekranet televizive, kryesisht të censuruara apo të politizuara, parakalojnë gjithfarë zyrtarësh të krekosur, ndërsa jeta e vërtetë mjegullohet. Hendeku po thellohet midis shumicës që varfërohet dhe një pakice që pasurohet në kurrizin e taksapaguesve. Mjerimi s'ka fat, ka vetëm zhele. Këto vargje të Migjenit e ilustronjë më së miri situatën e rëndë sociale në Kosovë, të cilën Qeveria përpigjet ironikisht ta zbukurojë.

JOTRANSPARENCË NË BISEDIMET ME SERBINË

Plani sekret për veriun

Qeveria e shpalosi vetëm në Bruksel




Ministria e Integriteteve Evropiane, Vlorë Çitaku, ka deklaruar të premtën se Qeveria e ka një plan të vetin për këtë temë, i cili është i njohur edhe për zyrtarët e lartë të BE-së

Ndikimi i politikës në emërimet në sistemin prokurorial

Një ish-qeveritar hyn në Këshillin Prokurorial

Ish-zv.ministri i Drejtësisë, Sylë Hoxha, në KPK



Në radhët e Këshillit Prokurorial, së fundmi është regjistruar anëtari më i ri, i cili vjen nga radhët e politikës. Sylë Hoxha, kryeprokuror i Qarkut të Prizrenit, është anëtari më i ri i KPK-së, i zgjedhur më 8 dhjetor 2012, i cili vjen nga radhët e politikës



RTK, 2 milionë euro borxhe

POLITIKË

4



**TRAGJEDI NË SHBA
Masakër në shkollën fillore, të paktën 27 të vrarë**

BOTË

42



FIFA hap një deriçkë për Kosovën!

SPORT

45



Ezani dhe kambana si traditë dhe ndikimi i teknologjisë

SHTOLCA PËR KULTURË

34

KOLEKSIONI I RI DIMËR

SHOPPING CENTER
City Park

PULL&BEAR

ZARA
man / woman / kids

Bershka

Adresa: QT. "City Park" Zona industrial, Prishtinë | City Park 2: Rruga e UÇK-së te Qafa, Prishtinë

Vitrina e Librit

1. SINAN GASHI "ALBUMI I SHKRIMTARËVE SHQIPTARË I"



Studiuesi i letërsisë shqiptare, Sinan Gashi, pas 25 veprave të asaj natyre, në 100-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë botoi albumin e parë të shkrimtarëve shqiptarë, duke filluar që nga Shën Jeronimi e deri te e reja Albulenë Pllana. Në këtë album janë përfshirë më se 785 portrete shkrimtarësh, nga të cilët edhe ata që kanë krijuar në gjuhë të huaja, që nga hershmeria e deri edhe të disa sish që kishin mbetur në harresën e kohës, kryesisht për arsye të natyrës politike. Pra, për herë të parë, kemi mundësinë që t'i kemi të gjithë në një vëllim, pa e marrë për bazë bindjet e tyre politike e fetare, por vetëm atë kombëtare. Kjo është një vepër e rrallë dhe me vlerë të veçantë për kulturën tonë. Libri i ka 426 faqe. E botoi autori, Prishtinë, 2012.

2. SELATIN NOVOSELLA "75 KOSOVA"



Pjesa e tretë e trilogjisë dhe e fundit, "Kosova", me nën titullin "Procesi i Prishtinës", e Selatin Novosellës, pasqyron në mënyrë të dokumentuar procesin politik të Prishtinës më 1975, ku padrejtësisht u dënuan ideatorët e lëvizjes revolucionare të Kosovës, u dënuan Adem Demaçi dhe 35 të tjerë, për të cilët shkruan në këtë libër. Në këtë pjesë të trilogjisë gjithashtu do të gjejmë se cilët ishin politikanët udhëheqës të Kosovës, të cilët u implikuan në organizimin e këtij procesi, pastaj për qëllimin e këtij procesi të montuar politik, për torturat që përdorëshin ndaj të burgosurve, qëndrimin e të burgosurave para gjyqit, veçmas të Adem Demaçit, e shumë informata të tjera për ngjarjet që karakterizuan periudhën e pasluftës së Dytë Botërore të shqiptarëve të ish-Jugosllavisë, veçmas të Kosovës.

3. SMAJL SMAKAJ "PAVDEKËSIA E POETIT"



Sapo ka dalë nga shtypi libri "Pavdekësia e poetit" i Smajl Smakajt, një libër me kujtime për poetin tashmë të ndjerë Ali Podrimja. Në këtë libër janë përfshirë shkrimet e ndryshme të autorëve shqiptarë, por edhe të huaj, që janë shkruar për Podrimjen, pas vdekjes, si shkrimi i Ismail Kadare, i Adem Gashit, Jonuz Fetahajt, Agim Vincës, Besim Bokshit, Shaqir Foniqit, Kostas Valetasit, etj. Në parathënien e këtij libri Smakaj ka shkruar se idenë dhe nxitjen për të shkruar një libër të tillë e ka pikërisht nga Ali Podrimja, i cili, siç shkruar Smakaj, i është lutur që pas vdekjes t'i bëjë një libër me kujtime të krijuar dhe përkthyesve të poezive të tij.

REPORTAZH EKSKLUZIV PËR "KOSOVA SOT"

Dr. Gjekë Marinaj, nga Malësia e Madhe tek arritjet e mëdha



SHKRUAN:
SHEFQET DIBRANI,
ZVICËR

Gjekë Marinaj është pedagog, poet, përkthyes dhe kritik letrar nga Malësia e Madhe e Shqipërisë që banon prej 21 vjetësh në Amerikë. Ai është themeluesi i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikane (2001) dhe fitues i disa çmimeve për arritjet akademike dhe Letrare. Më 5 nëntor 2012 e ka mbrojtur doktoratën me temë: "Poezia orale në Shqipëri dhe kulturat e tjera ballkanike: Përkthimi i labirinteve të së papërkthyeshmës". Më 6 dhjetor 2012, ai e pranoi gradën shkencore Doktor në Filozofi (PhD) dhënë nga UTD (Universiteti i Teksasit në Dallas), kurse më 8 dhjetor 2012, atij iu dorëzua edhe Diploma PhD që është grada më e lartë shkollore që ofrojnë universitetet në Amerikë. Ceremonia e këtij evenimenti akademik u dha direkt nga disa televizione lokale në Dallas, si dhe në internet, për të interesuarit kudo në botë



Dr. Frederick Turner dhe dr. John Wirkowski duke i vënë kurorën akademike të gradës PhD, dr. Gjekë Marinajt

me miqtë e tjerë, kudo i shoqëron zonja e shtëpisë, bashkëshortja e Gjekës, Dusita Marinaj, e cila padyshim ka merita të mëdha për suksesin e burrit të saj, i cili pohan se "Dusita më ka dhënë një ndihmesë të jashtëzakonshme gjatë studimeve, sepse pa një jetë me dashuri të pastër dhe paqe të plotë në shtëpi është gati e pamundur të gjej sukses në jetën akademike". Që të mos zgjerohemi me detajet dhe anë teknike të ceremonisë në fjalë, këtë reportazh të shkruar po e ilustrojmë me mendimet e personaliteteve akademike në UTD dhe Kolegjin ku ai ligjeron, për t'i lënë vend edhe një shënimi biografik. Në këtë plan vien për t'u cituar shënimi i vënë në librezën e ceremonisë së laureatëve të Doktoratës, së datës 6 dhjetor 2012, botuar nga Universiteti i Teksasit në Dallas, shënim ky për Marinajn që është shkruar nga kandidati për çmimin Nobel në letërsi Prof. Frederick Turner i cili thotë: "Poetët e mirë janë të rrallë. Poetët e mirë që kanë edhe komandën e gjuhëve të jenë përkthyes të mirë janë edhe më të rrallë. Kur një njeri i tillë është, me të drejtë, edhe një hero nacional siç është Gjekë Marinaj për Shqipërinë - i cili mezi u shpëtoi armëve të regjimit komunist që kërkonin jetën e tij vetëm se kishte shkruar një poezi kritike kuder regjimit, një poezi që u kthye në britmen kolektive të demonstratave që i sollën lirinë vendit - ne kemi diçka edhe më të rrallë. Kur ky indi-

vid ka kompozuar si pjesë të disertacionit të tij një antologji shumë të rëndësishme, akoma të pabotuar, të poezisë gojore shqipe, dhe kur ai është i diplomuar nga universiteti ynë, në duhet ta njohim fatin tonë për ta laureuar sot atë!"

REALIZIMI I ENDRRËS
Profesoresha Charlotte Karam, kolege e punës në Kolegjin Richland (Richland College), aty ku Gjekë Marinaj prej sa vitësh është mësimsdhënës, deklaroi: "Si mike dhe kolege e Gjekë Marinajt, e kam parë atë duke punuar dhe studiuar në të gjitha orët e ditës dhe natës për detyrimet e tij akademike dhe qëllimet letrare. Sot ai ka realizuar një nga ëndrrat e tij më të mëdha: fitimin e titullit Doktor i Filozofisë në Shkencat Humane. Jam e sigurt se ky "diamant" Amerikan nga Shqipëria do e përdor kohën dhe talentin e tij për të arritur majat edhe më të larta!" Ndërsa Gjekë Marinaj, me modestin e tij prej njeriu dhe intelektualit me këtë rast do të shtonte: "Këtë piketë të rëndësishme në jetën time ua dedikoj të gjithë mësuesve (duke filluar nga prindërit e mi) dhe profesorëve nga Shqipëria deri në Amerikë, të cilët gjatë kohës së studimeve, përmas dashurisë njerëzore, sakrificës personale dhe dedikimit profesional më kanë dhënë mbështetjen e duhur njerëzore dhe akademike, pa të cilën diplomimi im nuk do të kishte qenë i mundur".

Më datën 6 dhe 8 dhjetor 2012, në qytetin e Dallasit, në Amerikë, përkatësisht në ambientet e Universitetit të Teksasit në Dallas (UTD), u mbajt ceremonia e diplomimit të rreth 1911 studentëve, të cilët i kanë përfunduar studimet e niveleve të ndryshme pranë këtij Universiteti. Nga Shkolla e Arteve dhe Shkencave Humane u diplomuan më PhD katër studentët: Dr. Dallie Bremer Clark, Dr. Anne Healy, Dr. Gjekë Marinaj dhe Dr. Jeffrey F. Pettino. Ky i fundit, për arsye personale, nuk mori pjesë në këtë ceremoni. Ndonëse kjo ngjarje është e rëndësishme për qytetin e Dallasit dhe shoqërinë amerikane, për ne shqiptarët nuk do të kishte atë rëndësi që ka, sikur sivjet të mos laureohej me gradën akademike PhD edhe Gjekë Marinaj, shqiptarë nga Malësia e Madhe, emër publik, poet e përkthyes i njohur, si dhe një pedagog dhe studiues i zellshëm.

MYSAFIRË TË SHUMTË
Në ceremonitë festive, për ta nderuar dhe respektuar njeriun e tyre, kishin udhëtuar nga Tirana, midis tjerësh, edhe Tonin dhe Lindita Marinaj, të cilët bashkë

Biografia dhe karriera

Gjekë Marinaj lindi në Brurt të Malësisë së Madhe, Shqipëri, në vitin 1965. Ka botuar disa libra me poezi, prozë, kritikë letrare dhe përkthime. Në vitin 2001 ka mbaruar Fakultetin e Shkencave të Përgjithshme (Associate In Science) në Brookhaven College. Katër vjet më vonë, mbaroi Shkollën e Arteve dhe Humanizmit (Bachelor of Arts in Literary Studies: Magna Cum Laude) në Universitetin e Teksasit në Dallas. Shkollën e Arteve dhe Humanizmit (Master of Arts in Humanities-Studies in Literature) e mbaroi në vitin 2008 në UT Dallas. Më 8 dhjetor 2012, është diplomuar me gradën PhD (Doktor i Filozofisë) në Shkencat Humane nga Universiteti i Teksasit në Dallas.

Në vitin 2003 është nderuar me Çmimin "Pena e Artë" nga SHSHSHA. Çmimin e Parë në poezi, akorduar nga revista letrare amerikane "Sojourn", e pranoi në vitin 2006. QNK (Qendra Ndërkombëtare e Kulturës) e nderoi me çmimin "Pjetër Arbërori" në Letërsi në vitin 2008. Ndërsa më 30 Janar, 2012, u nderua me çmimin "Albanian BookerMan në Letërsi" për krijimin e "Protonizmit" (një teori e re letrare dhe filozofike) nga Kompania Mediatike "NACIONAL" e Shqipërisë. Dr. Gjekë Marinaj, është pedagog i gjuhës dhe komunikimeve Angleze dhe i lëndës së Letërsisë Botërore në Richland College në Dallas të Teksasit, ku jeton me gruan e tij Dusita.